



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

SHPALLJE E KONKURSIT

Udhëheqësi i Personelit Komuna Kaçanik në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-149 për Ligjin e shërbimit Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 neni 4,5,6 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, Ligjit Nr.03/L-068 për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (neni5) , neni 58 paragrafi (f), të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale , neni 86 të Statutit të Komunës dhe udhëzimit Administrativ për procedurat e zgjedhjes së Drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese numër:3/2009 si dhe autorizimit të MAP-it DASHC/MAP 04/340 të datës **11.03.2013** shpallë konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës:

TITULLI I VENDIT TË PUNËS:

I. DREJTOR NË QEAP "AGIMI" Kaçanik

II. DREJTOR NË SHFMU „Jusuf Grvalla” Bëçec

III. DREJTOR NË SHFMU „Adylgafurr Luma” Gllloboçicë

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: **Koeficienti 7.8**

Numri i referencës së vendit të punës: **01-16-6117/13**

Detyrat dhe përgjegjësitë

Pozitat e I

- 1: Është përgjegjës për menaxhimin e entit parashkollor
- 2: Harton plan- programin e punës
- 3: Është përgjegjës për krijimin e kushteve ditore për fëmijët e të gjitha grupeve
- 4: Përcjell punën e edukatoreve në realizimin e plan-programit të punës.
- 5: I raporton Drejtorit të DKA-së për aktivitetet në kuadër të plan-programit
- 6: Zbaton ligjin për arsim në Komunat e Republikës së Kosovës

Pozita e II dhe III

- 1: Është përgjegjës për mbikqyrjen e Punës Edukativo-Arsimore në institucion
- 2: Plotëson dhe përcjellë çdo raport të kërkuar nga DKA ose MASHT
- 3: bënë kontrollimin e ditarëve dhe fletoreve të punës.
- 4: bënë hospitimin e arsimtarëve gjatë procesit mësimor.
- 5: Viziton paralelet e ndara nëse ka.
- 6: Mban takime të këshillit drejtues, këshillit të prindërve, dhe këshillit të nxënësve.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar.

Procedurat e konkurrimit: e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues

Shkollimi i kërkuar: Të kenë të kryer njërin nga fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve private të akredituara dhe të licencuara nga MASH, të ketë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim.

Aplikacionit ti bashkangjiten këto dokumente: Certifikata e lindjes; Diplomën e fakultetit të kryer; Dëshminë për përvojën e punës; CV-in sipas modelit të MASHT-it; Rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibël; Programin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar(më së shumti 5 faqe test me 30 rreshta të letrës formati A4; Certifikatat e trajnime të zhvilluara; Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe udhëzimit 03/2009 të MASHT-it

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimore - **Zyra e pranimit**, kati përdhes dhe në web-faqen Komunale .

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”
“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kaçanik, 12.03.2013

**Udhëheqësi i Personelit
z. Fadil Guri**